

Fejton: “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992) (10)

BE-ja ia bëri si OKB-ja Kosovës: “Standardet para statusit”

Për vend në BE, një shtet duhet të jetë demokratik, me ekonomi tregu, duhet të respektojë të drejtat e njeriut dhe dyzet mijë rregulla të tjera të standardeve të BE-së. Megjithatë, kjo formulë u tregua mjet efikas për reformimin e shumë shteteve të Evropës Lindore dhe të asaj Qendrore

Zhvillimet e viteve '90, shtyn BE-në që ndaj kandidatëve potencialë për anëtarësim të sillen si OKB-ja ndaj Kosovës - “Standardet para statusit”. Për vend në BE, një shtet duhet të jetë demokratik, me ekonomi tregu, duhet të respektojë të drejtat e njeriut dhe dyzet mijë rregulla të tjera të standardeve të BE-së. Stopimi i vendeve kryeneçe derisa nuk i përm-bushin standardet është dëshmuar të jetë mjet efikas në reformimin e shteteve të Evropës Lindore e të asaj Qendrore, marrë parasysh dëshirën e tyre të flaktë për integrim.

Nivelet e larta të organizmave ndërkombëtare dhe NATO-ja kishin injoruar një kohë zhvillimet në Ballkan, madje NATO nuk e konsideronte atë si territor që ka nevojë për masa ushtarake. Por në vitet 1990-1992 kjo u dëshmuar se përvoja e organizmave ndërkombëtare ishte e pamjaftueshme. BE-ja ndërroi mendje kur serbët filluan sulmet në caqet kroate.

Në takimin në Brione, pak pasi Kroacia e Sllovenia shpallën “disociimin” nga Jugosllavia, shefi i delegacionit evropian, holandezi

Hans Van den Broek, nuk e kishte idenë se çfarë zihej aty. Kur kryeministri jugosllav, Ante Marković deshi të prezantojë propozimet për mbajtjen e Jugosllavisë unike, ai iku nga takimi duke mërmëritur: “Çfarë njerëz! Çfarë vendi!”

Pa u matur shumë, negociatorët evropianë pranuan idenë e nacionalistëve se Jugosllavia po copëtohej dhe se shumica e jugosllavëve donin ta mbanin shtetin unik - më e udhës do të ishte që Sllovenia e Kroacia të detyroheshin në një moratorium 90-ditësh për shpalljen e pavarësisë.

Sllovenia kaloi gati pa probleme; Kuçani arriti relativisht shpejt një marrëveshje me Milosheviqin. Ndonëse diplomacia evropiane nuk luajti ndonjë rol aty, evropianët u përgëzuan për përfundimin e shpejtë të armiqësive në Slloveni dhe iu rrit vetëbesimi për aftësitë në menaxhimin e situatave të tilla.

Por një vit pas takimit në Brione gjërat po keqësoheshin, Këshilli Evropian mbajti një konferencë për Jugosllavinë dhe emëroi lordin Peter Carrington si kryenegociator.

Përkundër takimeve të vazhdueshme, ai e shihte çdo herë më të vështirë, në mos të pamundur, që të përfundonte negociatat. Kur pesë nga gjashtë republikat jugosllave pranuan në parim planin që Jugosllavia të rikonstituohet si federatë apo aleancë e “republikave sovraane dhe të pavarura me status ndërkombëtar për ato që e dëshirojnë; me marrëveshje të qëndrueshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe status special për disa grupe dhe regjione”, e vetmja republikë që nuk e pranoi ishte Serbia. Milosheviqi thoshte se një marrëveshje e tillë serbët që jetojnë në republika jo-serbe do t'i shëndrronte në minoritet.

Ai insistonte se serbët duhet të konsiderohen “sovrane” në ato republika. Aq më pak Milosheviqi donte t'u jepte status sovraniteti shqiptarëve që jetonin në Kosovë. Liderët serbë nuk shihnin asgjë të keqe në këtë qëndrim jologjik të Milosheviqit.

“Serbët kanë të drejtë jo vetëm në territoret ku jetojnë tash por edhe në ato ku janë varrosur meqë toka ku ata prehen u është marrë padrejhtësisht”, thoshte Radovan

Karaxhiqi. I pyetur nëse edhe kosovarët e boshnjakët duhet ta gëzojnë këtë të drejtë, ai pat thënë: “Natyrisht se jo. Kroatët janë fashistë e myslimanët janë fanatikë islamistë” Konferenca e KE-së serbëve u dha afat që deri më 5 nëntor të pranonin planet për federatë, që përfshinte parimet e “moslejimit të ndryshimeve të njëanshme të kufinjve, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të grupeve etnike”, përndryshe Konferenca me republikat e gatshme për bashkëpunim do të gjente zgjidhje politike, me perspektivë të njohjes së pavarësisë për ato republika që e duan atë. Me këtë Serbia u informua se nëse nuk heq dorë nga kërkesa për sovranitet të serbëve në Bosnjë e Kroaci dhe të pranonte statusin e tyre si minoritet, mund të priste që fuqitë evropiane të njihnin pavarësinë e republikave tjera jugosllave pa ua vënë veshin serbëve.

Kjo tregon se sa peshë çonte çonte për serbët puna e statusit prej pakice.

Anëtarët e KE-së e ndjenin se mund të mbroheshin të drejtat e pakicave, të paktën ato ele-

mentare, poqese Kroacia e Bosnja pranojnë normat evropiane për të drejtat e minoriteteve.

Prej vitit 1984 deri në rënien e komunizmit të paktën shtatë konventa ndërkombëtare ndalonin një varg shkeljesh të të drejtave të njeriut, gjenocidin, diskriminimin gjinor, torturat dhe akte të tjera jonjerëzore e degraduese, ndërkohë mbronin të drejta qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Dy institucionet, Këshilli i Evropës dhe Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (më vonë OSBE-ja), ndonëse përgjegjëse për këto të drejta, asnjëra nuk kishte mundësi që të ndërhyjë në një shtet sovran për të mbrojtur të drejtat e pakicave, që do të thoshte se nuk kishte mekanizma për të siguruar se kështu do të ndodhte.

(Nesër: Deri në cilën masë kishte pozicioni serb në Kroaci bazë të arsyeshme? Cilat ishin sfidat legaliste me të cilat përballej Bashkimi Evropian në trajtimin e problemit të trashëgimisë së mjeteve të ish-RSFJ-së?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (12)

Darka me sicilianët

Dy mysafirët kishin përpara pjatat të mbushura me mish dhe gotat të mbushura me verë. Në krye të vendit ishte i ulur Capone, me gojën vesh më vesh. Ai u ngrit në këmbë: “Gëzuar Scalise! Gëzuar Anselmi!” Tre burrat hëngrën e pinë deri pas mesnate. Pastaj, Capone u ngrit sërish në këmbë. Këtë herë nuk do të ngrinte dotli

Masakra e ditës së të dashuruarve bëri më shumë bujë se ç'kishte pritur Al Capone. Madje, lajmi e bëri me ethe edhe Shtëpinë e Bardhë. Presidenti Herbert Hoover kishte dhënë urdhër: “Menjëherë, është urdhër, të

gjitha agjencitë federative të përqendrohen në z. Capone dhe aleatët e tij”. Sekretari i Thesarit të shtetit, Andrew Mellon, ishte vënë nën kritika të ashpra për paaftësinë që të kapet Capone.

“E dua Caponen në burg dhe pikë”, i kishte bërë titull presidenti Hoover.

Pak ditë më vonë, Capone u thirr të dilte para gjyqit. Mirëpo, ai as që e mori seriozisht atë punë dhe vendosi ta injoronte ftesën fare. Në atë fillim të vitit 1929, Capone më shumë brengosej për gjëra të tjera dhe njëra nga këto gjëra ishte fakti se dy miq të tij nuk kishin mësuar asgjë nga vrasja e Frank Yalet dhe po i shkaktonin telashe shefit të tyre.

Fjala ishte për John Scalisen dhe Alberto Anselmin, dy sicilianët që kishin marrë pjesë në masakrën e Shën Valentinit që kishin nisur t'u bishhtonin fjalëve të kumbarës së nëntokës. Capone i kishte mënyrat e veta se si i zgjidhte problemet dhe një shishe verë shpeshherë ndihmon.

Atë natë në shtëpinë e Al Capones kishte pasur shumë më shumë se një shishe verë. Dy mysafirët ishin ulur përskaaj tavoline. Para tyre ishin pjatat e mbushura me mish dhe gotat plot verë të kuqe. Në krye të vendit, Capone, i kishte nxjerrë dhëmbët e tij të mëdhenj e të bardhë dhe po qeshej vesh më vesh. Pastaj ngriti dotli: “Gëzuar Scalise! Gëzuar, Anselmi!”

Tre burrat rreth tryezës së shtruar pinë e hëngrën deri pas mesnate, kur Al Capone e shtyu karrigien e tij dhe u ngrit në këmbë.



Dy sicilianët, Alberto Anselmi (majtas) dhe John Scalise, njiheshin si vrasësit më të rrezikshëm të kohës së tyre. Kur kishte nisur të dyshonte në besnikërinë e tyre, Al Capone kishte vendosur t'i thërriste për darkë

Hestja e kaploi dhomën për një çast. Dy mysafirët e shikuan fytyrën e Capones. Buzëqeshja ishte zhdukur. Fytyrat e tyre u zbehën. Sytë e tyre zunë të shikonë teposhtë. Pastaj, buçiti zëri i Capones. Me zë të ashprë ai po i qëllonte dy mysafirët si me gurë. “Kujtuat se unë nuk e di? Se nuk e marr vesh? Kujtuat se jua fal tradhtinë?”

Ishte adet i vjetër ky: mikpritja para vrasjes. Dy sicilianët nuk kishin nga t'ia mbanin. I kishin dorëzuar armët e tyre te porta, kur kishin ardhur si mysafirë nderi në shtëpinë e shefit të tyre. U ngritën shpejt nga karrigiet dhe deshën të iknin duke kërcyer nga dritaret, por truporjat e Capones ishin syqelë. Dy mysafirët mbetën të ulur në karrigje. Capone ishte në këmbë me një shkop bejsbolli në dorë. Iu afrua ngadalë Anselmit dhe e goditi me tërë for-

cën në kokë. Pastaj vazhdoi ta godiste në krahë, në gjoks dhe në shpinë.

Scalise po shikonte i tmerruar: “Al, mos të lutem!”, ishte lutur ai. Capone nuk po dëgjonte fare. Iu afrua dhe nuk la vend pa e goditur në trup me shkopin e tij. Të dy sicilianët mbase tashmë kishin vdekur, por një nga truoprojat e Capones, për çdo rast, ua dha edhe nga një plumb në kokë. Anselmi dhe Scalise kishin vrarë për Caponen Dion o'Banionin, Hymie Weissin dhe kishin marrë pjesë në masakrën e Shën Valentinit.

(Nesër: Kush e shpalli Caponen armikun nr. 1 të shtetit? Cilat ishin përpjekjet e presidentit Hoover? Kush ishte Eliot Ness? Kur u kërkuar kthimi i Johnny Torrios në nëntokën e krimit?)

Gangsterë të tjerë të shquar Aleksandr Solonik

Aleksandr Solonik është njëri ndër vrasësit më të aftë dhe më mizor në historinë e krimit të organizuar, ndërsa me dorë të vet ka vrarë disa nga bosët më të mëdhenj të mafias në Rusi. Solonik i lindur më 1960 në ish-BRSS kishte qenë pjesëtar i njësiteve elite të komandosëve të ish-BRSS-së, por ishte përjashtuar nga detyra për shkaqe të panjohura dhe ishte kthyer në vendlindjen e tij për të punuar si varrmihës. Më 1987 ishte akuzuar për dhunim dhe ishte dënuar me 8 vjet burgim. E kishin dërguar në famkeqin Gulag.

Të burgosurit e atij burgu ishin njerëz të vështirë dhe kur e kishin marrë vesh se Solonik ishte ish-ushtar kishin vendosur ta vrisnin. Në Gulag nuk kishte rregulla dhe rojtarët e burgut nuk të mbronin. Mirëpo, Solonik vendosi të kundërpërgjigje. Dymbëdhjetë burra e sulmuan ta vrisnin dhe ai ia doli që t'i rrahë që të dymbëdhjetët. Pas kësaj, kurrkush nuk guxonte t'i bënte as ciu në burg. Vetëm dy vjet më vonë, ia doli të ikte nga burgu. Në vitet nëntëdhjetë nisi të punonte si vrasës me pagesë. Vrau një nga një disa nga bosët më të mëdhenj të Rusisë. Valeri Nikiforov, Valeri Dugatscj dhe më i madhi nga të gjithë Otari Kvantrishvili, i cili konsiderohet mafiozi më i madh i të gjitha kohërave në Rusi, u vranë brenda pak vjetësh nga dora e Solonikut. Policia e arrestoi më 1994, por ai iku nga burgu menjëherë pas një viti.

Legjenda e tij përfundoi më 1997, kur autoritetet greke e gjetën kufomën e tij në afërsi të Athinës. Kurrë nuk u mësua se kush e kishte vrarë. Legjendat ruse thonë se kufoma as nuk ka qenë e tij. Megjithatë, ai konsiderohet vrasësi më i rrezikshëm që ka vepruar ndonjëherë.